



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:013401

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06789398

KF.nr.801/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Te Ylli & Lumi”, ShPK, me numër unik identifikues 811341635, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit – rivlerësim malli, vlerë e kontestit 8,057.42 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 23.01.2025, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Kushtrim Bytyqi Avokat dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Xh. K, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Te Ylli & Lumi”, ShPK, me numër unik identifikues 811341635, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/20580, i datës 10.12.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Te Ylli & Lumi”, ShPK përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 24.01.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 01.3.2.2/24184. Si në padi ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore përkatësisht nenit 33 të KDAK lidhur me nenin 123 të UA nr 11/2009 pasi që paditësi DUD-it kontestues i ka bashkangjitur dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit përkatësisht çmimin e paguar në emër të mallit të deklaruar sipas DUD kontestues e të cilat dokumente dhe ndërlidhja e tyre është elaboruar më në detaje në pikën 2.5 të padisë. E

paditura e ka ri vlerësuar mallin e paditësit duke u bazuar në një faturë tjetër e cila është gjetur së bashku me mallin me rastin e kontrollit fizik të tij, mirëpo siç mund të shihet nga shkresat e lëndës kjo faturë me nr. LL 20201929 nuk ka të bëjë me mallin e deklaruar sipas DUD kontestues sepse nuk përputhet sasia dhe e njëjta është bashkangjitur gabimisht në dërgesë nga eksportuesi pasi që ka qenë njoftim përkatësisht ofertë për importet e radhës. E paditura është mjaftuar me vlerën më të lartë të kësaj fature pa e bërë asnjë analize tjetër në kuptim të përputhjes të sasisë së mallit dh epa marr asnjë konfirmim nga importuesi. Siç mund të shihet nga shkresat e lëndës në dërgesë ka qenë e bashkangjitur edhe fatura nr. LL02210729 në vlerë prej 33,432 USD e dt 29.07.2021 të cilën e paditura fare nuk e ka marr në shqyrtim dhe e cila ka një vlerë më të ulët. Nga kjo mund të konstatohet se eksportuesi nuk ka pasur kujdes në bashkëngjitjen e dokumenteve përkatëse për dërgesën lëndore. Me rastin e shqyrtimit të DUD-it kontestues e paditura nuk ka marr për bazë as praktiken doganore në bazë të DUD-ave referent të paraqitura nga vet paditësi siç është rasti me atë R-75629/24.09.2021 me ç'rast i është pranuar çmimi i deklaruar e po ashtu e paditura nuk ka elaboruar DUD-at tjerë referentë nga importuesit e tjerë ee as nga dosja e vlerës në mënyrë që të bëhet krahasimi i çmimeve referente nga çmimet e deklaruar nga paditësi por siç u theksua i ka mjaftuar vetëm një dokument me vlerë më të lartë dhe atë e ka konsideruar si çmim real. E njoftojë gjykatën se e paditura me arsyetimin se paditësi ka bërë shmangie nga detyrimet doganore sipas këtij DUD-i kontestues ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Shteti ku është zhvilluar procedurë hetimore dhe prokurori i shtetit ka gjetur se paditësi përkatësisht përfaqësuesi i tij me anë të DUD-ti kontestues ka paraqitur dokumentet relevante që vërtetojnë çmimin e deklaruar dhe ka pushuar hetimet me anë të aktvendimit PP.II.nr.5056/2021 dt 13.12.2024 të cilin dokument e dorëzoi gjykatës në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur, epo ashtu i bashkëngjis të përkthyer edhe deklaratën e eksportuesit të dt 19.10.21 si dhe konfirmimin e pagesave të dt 10.01.2022, po ashtu në kopje të mjaftueshme për palën e paditur. Duke marr për bazë të theksuarat i propozoj gjykatës të administrojë provat e bashkangjitura dhe të anulojë vendimin e atakuar dhe të detyrojë të paditurën që ti kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore sipas DUD kontestues në shumë prej 8,057.42 euro me kamatë në shkallë prej 8% nga data 18.10.2021 e deri në pagesën definitive për çka gjykatës i dorëzoi dëshminë e pagesës së taksave të datës 18.10.2021. Sa i përket metodës së parë të vlerësimit që nuk ka ndryshuar nga rubrika 43 konsiderojmë se është një shkelej tjetër e të paditurës pasi që edhe pse nuk ka pranuar vlerën e deklaruar nga paditësi përsëri nuk ka ndryshuar metodën e vlerësimit. Nuk qëndron fakti se fatura lëndore e deklaruar nga paditësi dhe ajo e gjetur nga e paditura kanë numër të njëjtë sepse fatura e deklaruar nga paditësi ka numër LL 20210729 ndërsa ajo e gjetur nga dogana ka numër LL20210929 e po ashtu

ndryshon edhe sasia e mallit sepse e para ka të përfshirë edhe mallin TVbox. Urdhërpagesat bankare në emër të mallit është e vërtetë se nuk kanë numër përshkrimi mirëpo eksportuesi me anë të konfirmimit të datës 10.01.2022 ka konstatuar se janë pagesa për faturën lëndore. Sa i përket aktvendimit të prokurorit të shtetit konsiderojmë se është dokument relevant për vendosjen e kësaj çështje të konfliktit administrativ pasi që përfaqësuesi i paditësit është kallëzuar penalisht për shmangie doganore por nuk janë gjetur prova për shkaktimin e kësaj vepre penale, përkatësisht prokurori i shtetit ka konstatuar se fatura e deklaruar nga paditësi pasqyron vlerën e mallit dhe kjo është çështje paraprake e zgjidhur nga prokuroria e shtetit lidhur me të cilën kjo gjykatë nuk ka tagër të vendos. Për shpenzime të procedurës nuk është deklaruar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës së paditur ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktvendimit kontestues duke konsideruar se ky vendim është tërësisht i drejtë dhe i ligjshëm dhe i bazuar në prova. Mbetemi në tërësi sipas përgjigjes në padi dhe i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të refuzojë në tërësi si të pabazuar. Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit të theksuara në padi dhe gjatë kësaj seance gjyqësore se e paditura ka bërë shkelje dispozitave ligjore të KDAK-së, nga kjo se nëse i referohemi DUD-it 81675 të dt 15.10.2021 në rubrikën 43 shihet se kemi të bëjmë me metodën e parë të vlerësimit (MV1) . Me rastin e deklarimit të mallit nga paditësi zyrtarët doganor përveç faturës së deklaruar në vlerë prej 36,110.00 USD kanë hasur edhe në faturën në vlere prej 67,352.80 USD e që të dy faturat përmbajnë numrin e njëjtë e që është LL20210929 por që ndryshon vetëm vlera e faturave. Andaj zyrtarët doganore me të hasur në fatura të dyfishta i janë referuar kësaj faturë sepse nëse shikojmë me kujdes janë në tërësi të ngjashme përveç ndryshimit në çmim. Pretendimi i paditësit se në këto dy fatura ndryshon sasia është pretendimi pabazuar sepse nëse i shikojmë në rubrikën e sasisë të dy faturat i kanë vlerat e njëjta. Më tej ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i paditësit në supozimin se ka bashkangjitur urdhërpagese relevante sepse nëse i referohemi kësaj urdhërpagesë ndërkombëtare në rubrikën e përshkrimit kemi konstatim të bankës “pagesa nuk është e bazuar në asnjë dokument” pra edhe nga ky aspekt shihet se këto dokumentet financiare nuk janë të harmonizuara. Sa i përket provave të

dorëzuar si aktvendimi për pushimin e hetimeve ka theksuar se konsiderojnë se ky aktvendim në procedurën doganore nuk mund të ketë ndikim për arsye se në ligjin për konflikte administrative në dispozitat që i mungojnë parasheh që përshtatshmërisht aplikohen dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore. E nëse i referohemi dispozitave të LPK-së gjykata civile-tani komerciale nuk mund të jetë e lidhur me aktvendime për pushim të hetimeve, me aktgjykime refuzuese përveç me përjashtim të rasteve kur kemi aktgjykim dënues me të cilin i akuzuari shpallet fajtor. Sa i përket deklaratave konsiderojë se sipas LKA-së nuk mund të konsiderohen këto prova pasi që të njëjtat nuk janë lëshuar nga organi komentet ku siç shihet të njëjtat janë lëshuar nga kompania kineze. Vlera e kontestit është e saktë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor gjyqësor-publik të datës 13.01.2025, ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/20580 e datës 10.12.2021, Ankesë në doganë e datës 21.10.2021, DUD kontestues R 81675 e datës 15.10.2021, Faturë LL20210729 dhe Packing list në vlerë prej 36,110 USD, Urdhërpagesë ndërkombëtare e datës 02.08.2021 dhe e datës 09.10.2021, CMR datës 14.10.2021, Faturë e transportit nr. 296/2021 dhe 295/2021, Faturë LL 20210929, Faturë nr. LL20210729 në vlere prej 33,432 USD, DUD referent R 75629 së bashku me faturën dhe packing list, Proces mbi kundërvajtjen administrative doganore, Aktvendim mbi pushimin e hetimeve i datës 11.12.2024, Deklaratë e eksportuesit e datës 10.01.2022 dhe 19.10.2021, Pagesë e taksave doganore 28.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-R81675, për zhdoganim në ZBD Prishtina, me ç'rast i njëjti është proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë ka nxjerr aktvendimin 01.3.2.2/20580, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën

administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar si e pabazuar dhe ka lënë në fuqi rivlerësimin e Sektorit të Pranimit Qendror, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 24.01.2022, ka iniciuar këtë kontest tregtar-administrativ.

Nga arsyetimi i vendimit konstatohet se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit me arsyetimin se Sektori për Menaxhimin e Përgjithshëm të Cilësisë, gjatë ushtrimit të kontrollit, ka zbuluar një faturë të dyfishtë me numër LL20210929 të datës 29.08.2021, në vlerë prej 67,352.80 USD, një vlerë dukshëm më e lartë se ajo e deklaruar, duke ngritur kështu proces për kundërvajtje doganore. Në vijim, rezulton se Dogana sqaron se, në rastin konkret, nuk është bërë rivlerësim i mallit, por zbatimi i metodës së parë të përcaktimit të vlerës, pasi sipas saj, vlera reale e mallit është ajo e faturës së dyfishtë. Pavarësisht dokumenteve të tjera shoqëruese të paraqitura nga paditësi, Dogana ka zbatuar nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave (KDA), duke argumentuar se në praktikat doganore shpesh vërehen tendenca për deklarimin e vlerave më të ulëta me qëllim shmangien e pagesës së taksave doganore në shumë të plotë. Gjithashtu, Dogana thekson se nuk ka gjetur asnjë motiv tjetër për paraqitjen e një vlere më të ulët nga subjekti, përveç synimit për shmangien e detyrimeve doganore. Për këtë arsye, vlera reale e mallit nuk është ajo e faturës së deklaruar nr. LL20210729, me vlerë prej 36,110.00 USD, por ajo e faturës së dyfishtë nr. LL20210929, në vlerë prej 67,352.80 USD. Së fundi arsyeton se pavarësisht pretendimeve të paditësit, i cili thekson se me rastin e deklarimit për doganim ka paraqitur të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për të vërtetuar vlerën reale të tij, Dogana ka vlerësuar se këto dokumente nuk e arsyetojnë paraqitjen e një vlere më të ulët. Për më tepër, Dogana argumenton se ndërhyrjet në çmimet e mallit janë të qarta, pasi çmimet dallojnë specifikisht për secilën njësi të mallit, duke mbështetur kështu vendimin për kontroll pas importues bazuar në faturën e dyfishtë, e cila përbën një indicie të mjaftueshme për veprimet e ndërmarra.

Gjykata, nga aktvendimi kontestues, konstaton se ai përmban të meta që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Këto të meta konsistojnë në arsyetimin e pamjaftueshëm dhe jo të plotë lidhur me rivlerësimin e mallit lëndor. Në arsyetimin e aktvendimit kontestues, nuk është ofruar shpjegim i bazuar dhe nuk është trajtuar fare deklarata e eksportuesit, e cila sqaron gabimet që kanë ndodhur gjatë transportit të mallrave.

Po ashtu, arsyetimi i të paditurës se për mallin e deklaruar ekziston faturë e dyfishtë, për Gjykatën nuk mbështetet në prova të administruara, pasi as numri i faturës, as sasia dhe as lloji i mallit

nuk përputhen. Konkretisht, fatura e deklaruar nga paditësi mban numrin LL20210729, ndërsa fatura e gjendur gjatë kontrollit pas importit ka numrin LL20210929. Gjithashtu, në faturën LL20210729 përfshihet edhe malli “TV Box”, i cili nuk figuron në faturën LL20210929. Për këtë arsye, për Gjykatën është e papranueshme që vetëm bazuar në ekzistencën e një fature tjetër të konstatohet se paditësi ka synuar shmangien nga pagesa e taksave doganore. Ky qëndrim përforcohet edhe nga deklarata e eksportuesit, të cilën e paditura mund ta konfirmojë përmes rrugëve zyrtare.

Në arsyetimin e vendimit kontestues thuhet se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit, duke pretenduar se vlera e deklaruar për zhdoganim nuk është ajo reale. Pretendimi bazohet në pohimin se vlera e deklaruar është më e vogël sesa ajo reale e paguar për mallin e importuar. Megjithatë, për Gjykatën, një konstatim i tillë është i paqëndrueshëm dhe i pambështetur në prova materiale. Ai është kontradiktor si në vetvete ashtu edhe në raport me dokumentacionin e paraqitur dhe bazën ligjore në fuqi. Për më tepër, e paditura nuk ka arritur të provojë këtë pretendim, as përmes ndonjë prove që do të dëshmonte se paditësi nuk ka paguar eksportuesin përmes transaksioneve bankare ose se ka paguar mbi çmimin e faturave blerëse të mallit.

E paditura duhet të analizoj mallrat e deklaruar për zhdoganim, llojin, sasinë dhe cilësitë tjera nëse ato përputhen me faturën e deklaruar apo atë të gjendur. Të deklarohet lidhur me transaksionin bankar të cilin e ka parashtruar paditësi si provë se është paguar vlera e mallit të deklaruar. Pretendimet e veta për shmangie nga taksat doganore ti arsyetoi dhe provoj me prova tjera, qofshin ato të zhdoganimeve të mëvonshme nëse fatura e gjendur edhe është deklaruar më pas nga paditësi me zhdoganimet e radhës, të ipet arsyetimi i mos pranimit të deklaratës së eksportuesit dhe analizimi i përgjithshëm i mallit të zhdoganuar në raport me dokumentet përcjellëse.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejtë gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohet lidhur me të dhënat e aplikuara me rastin e rivlerësimit të mallit kontestues dhe të aplikoj drejtë dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos mbi çështjen e konfliktit administrativ duke u mbështetur në faktet e vërtetuara gjatë procedurës administrative, në përputhje me nenin 43, paragrafi 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA). Në bazë të këtij parimi, Gjykata konstatoi se nuk mund të vendosë në mënyrë meritore për këtë konflikt administrativ, pasi ekzistojnë të meta që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Për këtë arsye, Gjykata aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar dhe e kthen çështjen për rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform neni 64, të LKA-së. Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura,

Gjykata konform neni 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.801/22, datë 23.01.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.